



KUSHTETUTA JONË



SISTEMI MË I MIRË I QEVERISJES


YLL (15), FIRESA (14), LANDRITI (14), FLORENTINA (14), AGRON (14), PRANVERA (14), RAJMOND (14), EDMOND (14)




Pse demokracia është sistemi më i mirë i qeverisjes

Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull ndërsa „kratos“ që do të thotë pushtet ose qeverisje. Demokracia për herë të parë është shfaqur në Greqi përkatësisht në kryeqytetin e saj Athinën në vitin 507. Elemente përbërëse të demokracisë janë: liria, respekti, paqja, pushteti, solidariteti, drejtësia, sovraniteti, toleranca, përgjegjësia etj.

Demokracia përbëhet prej dy sistemeve: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese. Demokracia e drejtpërdrejtë është sistemi ku vendimet merren aty për aty, ndërsa në demokracinë përfaqësuese populli voton deputetët, kurse deputetët e përfaqësojnë popullin. Populli, në një shtet demokratik ka fuqinë më të madhe sepse ai vendos se kush do ta qeverisë vendin. Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare ku secili qytetar ka të drejtë e votës mbi



moshën 18 vjeçare, sepse atëherë jemi më të pjekur dhe më mendjehapur. Nxënës të dashur, ne jemi ata që mund ta ndryshojmë të ardhmen tonë duke i respektuar parimet e demokracisë. Ne e bëjmë ndryshimin dhe ne gjithnjë duhet të kontribuojmë për të mirën e vendit tonë. Prandaj, ju ftojme edhe ju të tjerëve që t'i zbatoni të gjitha parimet e demokracisë sepse vetëm kështu mund të jetojmë të lumtur.



Ti vendos për të ardhmen tënde



Gazetarët e demokracisë

INSTITUCIONET E QEVERISJES

FLAMUR (15), ERIN (14), MUSTAFË (14), FATGZIM (15), QENDRESA (14), ADELINA (14), ANISA (14),
BEHARE (14)

DEMOKRACIA



Demokracia është qeveria e shtetit me anë të deputetëve të popullit që zgjidhet me anë të votave

Pushteti ndahet në tri institucione

- 1 Pushteti Legjislativ (Kuvendi-Parlamenti)**
- 2 Pushteti Ekzekutiv (Qeveria)**
- 3 Pushteti Gjyqësor (Gjykata)**

Pushteti Legjislativ ndahet në 3 funksione

- 1 Funksioni legjislativ (miratimi i ligjeve)**
- 2 Funksioni kontrollues (kontrollon qeverinë)**
- 3 Funksioni gjyqësor (përfaqëson popullin)**

Pushteti Gjyqësor ndahet në tri funksione

- 1 Gjykata themelore**
- 2 Gjykata e apelit**
- 3 Gjykata e apelit**

Pushteti Ekzekutiv (Qeveria) ndahet në 3 funksione

- 1 Detyrimi i projektligjeve në kuvend**
- 2 Përbajtja e projektligjeve**
- 3 Mirëmbajtja**

Ndarja e Pushteti në shtetin e Kosovës

Në një ekip futbollit, secili lojtar e ka rolin dhe përgjegjësinë e vet. Në këtë mënyrë, secili lojtar ndihmon ekipin dhe ekipi e ka punën më të lehtë.

Mirëpo, nëse e tërë puna do t'i lihej një lojtari të vetëm, ekipi nuk mund të kishte sukses. Për këtë arsye, lojtarët i ndajnë detyrat e tyre në ekip. Njësoj ndodh edhe në demokraci. Për shkak që një institucion të mos ngarkohet më tepër se tjetri, pushteti iu është ndarë tri institucioneve. Pushteti Legjislativ përfaqësohet nga Kuvendi. Qeveria i takon Pushtetit Ekzekutiv dhe Gjykatat i takojnë Pushtetit Gjyqësor.

Këto tri institucione punojnë në mënyrë të pavarur dhe të barabartë si dhe kanë përgjegjësi të ndryshme. Kuvendi është institucioni më i lartë i një vendi. Ai ka tri funksione: funksionin legjislativ, funksionin kontrollues dhe funksionin përfaqësues. Kuvendi ka funksion legjislativ sepse bën miratimin e projektligjeve që dërgohen në Kuvend. Ka funksion kontrollues sepse e kontrollon Qeverinë nëse është duke i zbatuar ligjet apo jo. Si dhe ka funksion përfaqësues sepse na përfaqëson neve (popullin). Kuvendi ndryshe quhet Parlament si dhe njihet si „Shtëpia e Popullit“. Në Kuvend punojnë 120 deputetë. 100 prej tyre zgjedhen nga populli që i përket shumicës, kurse 20 të tjerë zgjedhen nga komunitetet jo shumicë. Në Kosovë në komunitetet jo shumicë bëjnë pjesë: romët, ashkalinjtë, turqit, boshnjakët, egjiptasit dhe serbët. Qeveria ka për

detyrë që projektligjet t'i dërgoj Kuvendit. Gjithashtu, ka për detyrë që ligjet t'i ekzekutoj ose t'i zbatoj, si dhe të kujdeset për mirëqenien e popullit.

Ndërkaq, gjykatat kanë për detyrë që qytetarët për të cilët dyshohet që e kanë shkelur ligjin t'i gjykoj ata. Kjo sepse ligjet hyjnë në fuqi për të mirën tonë. Nga gjithë kjo që e thamë, kuptojmë se duhet të jemi të kujdesshëm se kë e zgjedhim dhe e votojmë, që të na përfaqësoj në Kuvend. Pse e themi këtë? E themi sepse përfaqësuesit tanë janë ata të cilët e udhëheqin shtetin tonë. E ne e dimë se sido që të vendosin ata do të ndikojë në jetën tonë. Kurse ne nga ju lexues të dashur, kërkojmë që të jeni sa më shumë demokratë dhe t'i mbani mend këto që i thamë.



Autorët e artikullit

ZGJEDHJET ELEMENT THEMELOR I DEMOKRACISË

BLERON (14), ARDIAN (15), EDONA (15), LORANA (15), RINESA (14), ARBËR (15), BLENDA (15), EDON (14)

Zgjedhjet janë shumë të rëndësishme sepse ne zgjedhim përfaqësuesit tanë, të cilët do të na përfaqësojnë për katër vitet e ardhshme

Demokracia është një formë e qeverisjes që i'u ofron njerëzve shumë të drejta, barazi dhe liri. Ndër elementet themelore të demokracisë janë zgjedhjet. Njerëzit kanë mundësinë të zgjedhin çdo ditë si për shembull zgjedhim si të ushqehemi, si të vishemi, si të bashkëjetojmë, si të bashkëpunojmë etj. Por, zgjedhjet si proces kanë dallim prej zgjedhjeve tona të përditshme. Zgjedhjet janë proces ku njerëzit japin votën e lirë për kandidatët e tyre të preferuar që do përfaqësojnë ata. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore dhe lokale. Zgjedhjet qendrore janë zgjedhje kur populli voton për përfaqësuesin e vet që janë deputetët, ndërsa zgjedhjet lokale janë kur populli voton për kryetar komune dhe asambleistët.



Autorët e artikullit

Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.



Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Për kë të votoj?!



18 vjeçari duke menduar për kë të votoj

A kemi ne të drejtë të votojmë?



Lorana duke e pyetur Edonën

Ne mund të votojmë në jetën tonë të përditshme, por në procese zgjedhore nuk mund të votojmë deri në moshën 18 vjeçare.



Edona duke i'u përgjigjur pyetjes së Loranës

QYTETARËT E KOSOVËS

ENDRITI (14), ALTINA (14), DRINI (14), BESLINDA (16), ALBINI (15), ELVINA (14), FLAKRONI (15),
BESARTI (15)



Të drejtat i kemi për t'i shfrytëzuar, ndërsa përgjegjësitë i kemi për t'iu përmbajtur

Edhe pse populli ynë është ndër popujt më të vegjël në Evropë, prapë se prapë jemi ndër popujt më të dashur. Si çdo shtet tjetër edhe shteti ynë ka ligjet e veta, dhe vetë qytetarët e saj pra ne, duhet të jemi të përgjegjshëm për to. Ligjet që janë në Kushtetutën e Kosovës duhet respektuar në çdo aspekt. Gjithashtu, nëse ndokujt i shkelet e drejta, ka të drejtë që të ankohet. Disa ligje që janë në Kushtetutën e Kosovës dhe janë votuar në vitin 2008, kanë të bëjnë me ndalimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë që të votojë lirshëm, pa u ndikuar nga të tjerët. Të drejtën për votim e kanë të gjithë qytetarët pa marrë parasysh gjininë, racën, fenë etj. Edhe ne si çdo qytetar të Kosovës kemi të drejtat tona, si: e drejta për shkollim, e drejta e punës, e drejta e emrit, e drejta e krijimit të familjes etj. Prandaj, ne duhet t'i respektojmë ato. Përveç të drejtave ne i kemi edhe përgjegjësitë tona. Përgjegjësi e jona është: pagimi i taksave, vijimi i mësimin të rregullt, mbrojtja e mjedisit dhe kujdesi për të. Ne kemi të drejtë t'i shprehim pakënaqësitë tona p.sh. nëse jemi në një punë, ndërsa shefi ynë na bën padrejtësi, ne mund të ankohemi pasi që kjo është e drejtë e jona. Ne kemi të drejtë ta zgjedhim profesionin pa u ndikuar nga të tjerët. P.sh. një shok i yni ka talent për muzikë, prandaj e drejta e tij është që ta shfrytëzojë talentin e tij. Pra ai

nuk duhet të ndikohet nga të tjerët, por duhet të përkrahët nga familja e tij. Të gjitha të drejtat kanë edhe përgjegjësitë e tyre. P.sh. mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e jona e cila ndikon edhe në shëndetin tonë. Për këtë arsye, duhet ta mbrojmë mjedisin dhe të kemi kujdes që të mos dëmtohet. Ne e kemi edhe të drejtën e shkollimit, por është edhe përgjegjësia e saj, pasi që duhet të vijojmë mësimin në kohë dhe t'i respektojmë rregullat e shkollës. Ndër të drejtat e çdo qytetari është edhe e drejta e krijimit të familjes dhe mbrojtja e saj. Kemi shumë të drejta dhe përgjegjësi, por shpresojmë që këto që i cekëm të kenë ndikuar tek ju, qytetarë të dashur. Ne nxënësit e shkollës fillore të mesme të ulët, ju sugjerojmë të gjithë bashkëqytetarëve që të mos e shkelin ligjin, sepse nëse e bëjnë atë do të ndëshkohen nga personat të cilët e kanë këtë kompetencë.



Jemi të lumtur që jemi pjesë e „Demos-ti“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Hilmi Rakovica“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-4
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë